

VENDIM
Nr.6, datë 5.3.2008

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese,
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “

me sekretare Brunilda Bara, në datën 19.2.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.3 Akti, që i përket:

KËRKUESI: PROKURORI I PËRGJITHSHËM I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, i përfaqësuar me autorizim nga z.Skënder Breca.

OBJEKTI: Interpretimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.9, datë 11.5.2006.

BAZA LIGJORE: Neni 80 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Kërkuesi parashtroi se:

- dispozitivi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 11.5.2006 është i paqartë, sepse nuk përputhet plotësisht me pjesën arsyetuese të tij;

- në arsyetimin e vendimit janë pranuar shkelje të standardeve të gjykimit vetëm për kërkuesin Arben Prifti, ndërsa në dispozitiv krijohet përshtypja se Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar tërësisht vendimin nr.129, datë 2.3.2005 të Gjykatës së Lartë si për kërkuesin Arben Prifti, ashtu edhe për të gjykuarit e tjerë Bujar Himçi, Edmond Aliaj e Veli Myftari.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes z.Gjergji Sauli, përfaqësuesin e kërkuesit dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.9, datë 11.5.2006, ka shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën vendimin nr.129, datë 2.3.2005 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, duke e dërguar çështjen për shqyrtim në këtë Kolegj.

Prokurori i Përgjithshëm, me kërkesën nr.191/1, datë 25.1.2008 drejtuar kësaj Gjykate, ka kërkuar interpretimin e vendimit nr.9, datë 11.5.2006 të Gjykatës Kushtetuese për shkak të paqartësisë së dispozitivit të vendimit në raport me pjesën arsyetuese të tij.

Duke iu referuar materialeve të çështjes dhe vendimit të saj nr.9, datë 11.5.2006, Gjykata Kushtetuese konstatoi se në pjesën arsyetuese të këtij vendimi është pranuar se në kuadrin e gjykimit të çështjes për një proces të rregullt ligjor, e drejta e mbrojtjes në këtë proces i është mohuar të gjykuarit Arben Prifti, duke përjashtuar të gjykuarit e tjerë. Ky fakt, që përbën thelbin e gjykimit të çështjes, trajtohet kuptueshëm në pjesën arsyetuese të vendimit. I paqartë paraqitet dispozitivi i vendimit, sepse nga formulimi i tij krijohet dyshimi që të jetë shfuqizuar tërësisht vendimi nr.129, datë 2.3.2005 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me efekte edhe për të gjykuarit Bujar Himçi etj.

Sipas nenit 80 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, kjo gjykatë ka në kompetencë të interpretojë vendimin e saj

në rast dyshimi ose mosmarrëveshjeje për kuptimin e tij, por pa ndryshuar përmbajtjen.

Në ushtrim të kësaj kompetence, Gjykata Kushtetuese çmon se, në rastin konkret, dispozitivi i vendimit të saj nr.9, datë 11.5.2006 duhet interpretuar në pajtim dhe harmoni me pjesën arsyetuese të këtij vendimi, në të cilin janë pranuar shkelje të standardeve të gjykimit për një proces të rregullt ligjor vetëm për kërkuesin Arben Prifti. Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se dispozitivi i vendimit nr.9, datë 11.5.2006, që shfuqizon si të papajtueshëm me Kushtetutën vendimin nr.129, datë 2.3.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ka efekt vetëm për kërkuesin Arben Prifti.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 80 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 11.5.2006, që shfuqizon si të papajtueshëm me Kushtetutën vendimin nr.129, datë 2.3.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, interpretohet se ka efekt vetëm për kërkuesin Arben Prifti.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryetar: Vladimir Kristo.

Anëtarë: Fehmi Abdiu, Gjergj Sauli, Xhezair Zaganjori, Kujtim Puto, Kristofor Peçi, Sokol Sadushi, Sokol Berberi, Petrit Pilloçi.